



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 039  
Datë: 27.08.2008.

Në mbështetje të nenit 94 pika 3, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Kryeministri i Kosovës, mori:

**V E N D I M**

**PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT MINISTROR PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN**

**1. Qëllimi i Vendimit**

Qëllimi i këtij vendimi është të themelojë Këshillin Ministror për koordinimin e procesit të Integrimit Evropian brenda Qeverisë së Kosovës (referuar më tutje në këtë Vendim si 'Këshilli Ministror').

Këshilli Ministror do të zbatojë politikat uniforme të Republikës së Kosovës për Integrimin Evropian duke lehtësuar, brenda spektrit të funksioneve dhe të drejtave të tij, koordinimin e aktiviteteve të ministrive dhe organeve të tjera për Integrim Evropian.

**2. Funksionet e Këshillit Ministror**

Këshilli Ministror ka funksionet si në vijim:

- Të koordinojë politikat uniforme shtetërore, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së Republikës së Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, dhe të përcaktojë fushat kryesore prioritare, aktivitetet për zbatimin e prioriteteve dhe afatet për zbatimin e tyre;
- Të diskutojë pozitat negociuese dhe çfarëdo çështjesh të tjera të lidhura me negociatat me Komisionin Evropian dhe Shtetet Anëtare para dorëzimit të këtyre

- pozitive dhe çështjeve nën negociim për vendim në mbledhjet e rregullta të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Të sigurojë një proces të planifikuar mirë dhe gjithëpërfshirës të përafrimit të akteve ligjore të Republikës së Kosovës me kërkesat e së drejtës së Komunitetit Evropian;
  - Të koordinojë zhvillimin dhe administrimin e programeve dhe aktiviteteve që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të ministrive dhe organeve të tjera shtetërore me qëllim të adresimit në mënyrë adekuate të kërkesave të procesit të Integritit Evropian;
  - Të vendosë mbi çështjet që lidhen me koordinimin e shfrytëzimit të asistencës së BE-së dhe asistencës bilaterale të donatorëve nëse kjo e fundit u destinohet çështjeve të Integritit Evropian, para dorëzimit të këtyre çështjeve për vendim në sesionet e rregullta të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
  - Të pajtohet me opinionin uniform të ministrive rreth çfarëdo çështjeje që lidhet me procesin e integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, duke përfshirë çështjet lidhur me zbatimin e Partneritetit Evropian dhe Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian.

### **3. Përbërja e Këshillit Ministror**

1. Këshilli Ministror ka këtë përbërje:
  - 1.1. Kryesuesi – Kryeministri;
  - 1.2. Zëvendës-Kryesuesi – Zëvendës-Kryeministri përgjegjës për Integrim Evropian;
  - 1.3. Anëtarë janë këta Ministra:
    - Ministri i Ekonomisë dhe Financave;
    - Ministri i Shërbimeve Publike;
    - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
    - Ministri i Punëve të Jashtme;
    - Ministri i Punëve të Brendshme;
    - Ministri i Drejtësisë.
  - 1.4. Bashkë-Sekretarët – Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Integrim Evropian.
2. Sekretarët e Përhershëm të ministrive të përmendura në nënparagrafin 1.3 të këtij Neni, këshilltarët e ministrave – anëtarë të Këshillit Ministror, Shef i Kabinetit i Zyrës së Kryeministrit ose zyrtari/ja i/e emëruar i/e tij/saj, mund të marrin pjesë në mbledhje, në kapacitet të këshilltarëve.
3. Në rast se kërkohet kështu nga agjenda e mbledhjes, Kryesuesi mund të vendosë të ftojë ministra të tjerë si dhe kryesues të organeve të tjera që të marrin pjesë në mbledhjen në fjalë. Në raste të tilla, rregullat e Paragrafit 2 të këtij Neni do të zbatohet në lidhje me zyrtarët e këtyre ministrive dhe organeve, të cilët mund të marrin pjesë në këto mbledhje në kapacitet të këshilltarëve.

#### **4. Zbatimi i Vendimit**

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Zyra e Kryeministrit, Kabineti i Zv. Kryeministrit, Ministrinë relevante dhe Agjencia për Integrim Evropian.

#### **5. Rrregullat e procedurës**

Rregullat e procedurës për Këshillin Ministror do të aprovohen në mbledhjen e parë konstituive të Këshillit Ministror.

#### **6. Hyrja në Fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha Ministrive (Ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- AIE
- Arkivit të Qeverisë